



RAPORTI I PUNËS
I
NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "STACIONI
I AUTOBUSËVE" SH.A. GJAKOVË
PËR VITIN 2023

Hyrje

- N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A. është i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve (*shkurtimisht*: ARBK) si Ndërmarrje Publike me aksionar 100% Kuvendin Komunal të Gjakovës, konformë Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Aktivitet e regjistruara:

- ✓ Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor
 - ✓ Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit
 - ✓ Transporti rrugor urban dhe ndërrurban i pasagjerëve
 - ✓ Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.
- Raporti i punës për vitin 2023, paraqet orientimet e Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A., në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të organeve drejtuese të Ndërmarrjes, gjegjësisht Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të Ndërmarrjes, ku të përmbledhura paraqiten vendimet, përfundimet, gjendja financiare dhe ajo e përgjithshme e Ndërmarrjes.

Historiku i Ndërmarrjes

Ndërmarrja Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A., në Gjakovë, ka traditë profesionale prej 66 vite në shërbimet transportuese të udhëtarëve.

E themeluar në vitin 1955 si veprimtari për shërbime transportuese, gjegjësisht bartjen e udhëtarëve në linjat urbane, urbane periferik, nder urbanë si dhe ato ndërkombëtare. Kjo ka vazhduar deri në vitin 1992, ku me tej me instalimin e masave të dhunshme gjithçka u rrënua, gjë që pas konfliktit të fundit të vitit 1999, nuk mbeti asgjë tjetër përveç karrocërve të autobusëve, inventarit të shkatërruar e të vjedhur, si dhe demolimet e objektit, si në oficinën mekanike ashtu edhe në Stacionin e Autobusëve.

Menjëherë pas luftës stafi u mbledh për rimëkëmbjen e ndërmarrjes dhe riorganizimin e saj, megjithëse ishte sakrificë sepse nuk ekzistonte asgjë, si dhe mungesa e mjeteve ishte e madhe dhe e theksuar.

Më pas ndërmarrja është regjistruar pranë Zyrës Civile Administrative të OKB në Gjakovë, me emërtimin “Kosovatrans Company” me numër të biznesit 80174942, këtë emërtim e kishte deri në vitin 2016 ku më pas që nga viti 2002 kalon në administrim të AKP-së (ish AKM-ja).

Me kalimin e viteve autobusët e siguruar (të vjetër), u amortizuan dhe në pamundësi financiare vetanak për të blerë të tjerët, u ndal pa dëshirën dhe vullnetin tonë ushtrimi i veprimtarisë për bartjen e udhëtarëve, mirëpo sot e kësaj dite vazhdon ofrimi i shërbimeve të peronizimit në Stacionin e Autobusëve. Operatorëve që veprojnë në linja të ndryshme si urban periferike, ndërrurbane si dhe ato ndërkombëtare, shfrytëzojnë nisjet nga Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, ku në çdo kohë i’u ofrohen shërbime korrekte gjithnjë sipas orareve të udhëtimeve të lejuara nga Ministria e Infrastrukturës së Kosovës.

Që nga data 30.05.2012 me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike 03/L-087 të publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr.13, është vendosur që Stacionet e Autobusëve të Komunave të jenë në pronësi të tyre, kështu që në bazë të këtij Ligji, Stacioni i Autobusëve në Gjakovë ka kaluar në pronësi të Komunës së Gjakovës 100%.

Me datë 05.11.2015, Stacioni i Autobusëve u regjistrua pranë ARBK si Shoqëri Aksionare, ku aksionar i 100% të aksioneve të saj është Komuna e Gjakovës. me numër të regjistrimit të biznesit: 71228673 numer unik: 811444900, numër fiskal: 601568233 si dhe numër të tvsh: 330311853 me adrese në Gjakovë, rruga "Kolë Lleshi", PN.

Vizioni

Ndërtimi i një sistemi të menaxhimit, bazuar në praktikat e mira, përmes aplikimit të politikave dhe procedurave kualitative si dhe ngritjen e kapaciteteve operative dhe financiare.

Vizioni është i bazuar në këto premisa:

- Intensifikimi i investimeve kapitale që mundëson rritjen e vlerës së aseteve dhe ofrimin e shërbimeve në fushën e transportit dhe qiradhënies.
- Rivitalizimi dhe digjitalizimi.

Misioni

- Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuar, hapësirave moderne në shërbim të klientëve si dhe transport në pajtim me politikat e gjelbërta.
- Hapësirat fizike të brendshme të SA SHA të i'u ofrojnë komoditetin, informacionet dhe shërbimet e nevojshme për udhëtarët që vijnë dhe shkojnë në dhe nga Gjakova.
- Digjitalizimin e nevojshëm për të i'u ofruar qytetarëve në kohë reale informacione mbi udhëtimet urbane dhe ndërrbane.
- Të gjithë klientëve shërbime me standardet me të larta.

Korniza Ligjore

Ligjet bazë të funksionimit të N.P.L."Stacioni i Autobusëve" SH.A. janë:

- ✓ Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
- ✓ Ligji Nr. 06/L- 016 për Shoqëritë Tregtare
- ✓ Ligji Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor

Ligje të tjera që ndikojnë në punë dhe aktivitet janë :

- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Ligji për Vetëqeverisjen Lokale”);
- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës,
- Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike (2008/03/L-048)
- Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat (“Ligji për PPP”);
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës
- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinorë (“Ligji për Planifikim Hapësinorë”);
- Ligji për Ndërtim etj.

Veprimtaritë / Aktivitetet primare dhe sekondare

N.P.L.”Stacioni i Autobusëve” SH.A.mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Aktivitet e regjistruara

1. Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor
2. Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit
3. Transporti rrugor urban dhe ndërrurban i pasagjerëve
4. transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.

SA SHA si veprimtari primare e ka:

- ✓ 5221 Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor

Aktivitetet sekondare:

- ✓ 5229 Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit

Aktivitete tjera:

- ✓ 4931 Transporti rrugor urban dhe ndërrurban i pasagjerëve
- ✓ 4939 Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.

I. Bordi i Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve i N.P.L.”Stacioni i Autobusëve”SH.A.,Gjakovë, në harkun kohorë Janar – Dhjetor 2024, ka mbajtur gjithsejtë 11 mbledhje të rregullta. Gjatë këtyre mbledhjeve janë marrur vendime, si dhe janë analizuar dhe shqyrtuar planet e punës, problematikat dhe afarizmi i Ndërmarrjes, ku sipas periudhave po përmendim ato më kryesore:

- Në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023 Bordi i Drejtorëve ka marrur vendim mbi Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi Mardhënien në punë të punëtorëve, përkatësisht paragrafin 1 të nenit 56 mbi pagesën përcjellëse me rastin e pensionimit.
- Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më datë 15.02.2023 ka marrur vendim mbi Shfuqizimin e Rregullores me nr.protokolli 53 e datës 11.02.2021 mbi paradhëniet (akontacionet).
- Në mbledhjen e mbajtur më 13.04.2023 është marrur vendim mbi miratimin e propozimit të Kryeshefit Ekzekutiv mbi ngritjen e tarifave të peronizimit për linjat urbano – periferike në vlerën prej 0.20 €.
- Në këtë mbledhje (13.04.2023) është nxjerrur vendim mbi formimin e grupit të ekspertëve të jashtëm për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Ndërmarrjes.
- Në mbledhjen e mbajtur më datë 13.06.2023 Bordi i Drejtorëve ka nxjerrur vendim mbi ngritjen e pagave të punëtorëve të Ndërmarrjes të cilët paguheshin nën vlerën e pagës mujore 300.00 €.
- Në muajin tetor 2023 është përzgjedhur Bordi i ri i Drejtorëve ku më datë 18.10.2023 është mbajtur mbledhja inauguruese me ç’rast është përzgjedhur Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve.
- Bordi i Drejtorëve gjatë këtij harku kohor 01.01.2023 – 31.12.2023 në vazhdimësi kanë shqyrtuar, analizuar dhe nxjerrur vendime mbi aprovimin dhe miratimin e akteve nënligjore, raporteve të punës, raporteve financiare si dhe Planit të Biznesit.

Burimet Njerëzore / Personeli

Punëtorët e N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë, janë të sistemuar në vendet përkatëse të punës sipas organogramit dhe Rregullores për sistematizim, ndërsa ndahen në njësime administrative dhe atë operative. Në njësime administrative janë të sistemuar gjithsej 12 zyrtarë (Kryeshefi Ekzekutiv, Sekretari, Zyrtari Financiar, Zyrtari i Prokurimit etj) , kurse në atë operative 24 punonjës (Shefi i Stacionit, Kordinator, Laurist, Biletar etj).

Anëtarë të Bordit Drejtorëve janë 4 persona (të emëruar nga Komisioni Komunal i Aksionarit) ku dy prej tyre janë meshkuj dhe dy femra.

Sipas vlerave të shprehura në % (përqindje), ndërmarrja ka këtë strukturë gjinore: kemi 26 punëtorë apo 72.2 % janë meshkuj dhe 10 punëtore apo 27.8 % janë femra.

Nr.	Struktura	Shqiptar	Romë	Egjiptian	Ashkali	Total	%
1	Struktura gjinore – meshkuj	23		3		26	72.2 %
2	Struktura gjinore - femra	9		1		10	27.8 %
1	Zyrtarët me shkollim të lartë	7				7	19.44 %
2	Zyrtarët me shkollim të ulët dhe të mesëm	25		4		29	80.56 %
Total (Numri i Punëtorëve)						36	100%

Kryeshefi Ekzekutiv dhe Shërbimi Administrativ Juridik

Kryeshefi Ekzekutiv dhe Shërbimi Administrativ Juridik i Ndërmarrjes gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar këto aktivitete:

- Nxjerrja e Vendimeve administrative
- Vendime per pushime vjetor.
- Shpallja e konkurseve për pranimin e punëtorëve
- Kontratat per themelimin e mardhënies së puës
- Kontrata për punë dhe detyra specifike.
- Kërkesa per shpalljen e tenderëve dhe ankandeve publike
- Përpilimi i raporteve tre mujore dhe vjetore
- Kontratat me qiramarrës dhe operatorë transportues
- Përgatitja e dokumenteve zyrtare: Kërkesave, Njoftmeve, Verejtjeve, Vendimeve te BD-ve, vendime te ndryshme si dhe pune te tjera per nevojat e ndryshme te kesaj ndermarrje.
- Ndjekja e proceseve gjyqësore të trashëguara dhe atyre të reja

Aktivitetet e Prokurimit

Zyra e prokurimit gjatë kësaj periudhe ka realizuar të gjitha procedurat e prokurimit sipas kërkesave të njësive të cilat janë aprovuar dhe autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv (ZKA), dhe ka përpiluar raportet të cilat paraqiten si obligime ligjore bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Përshkrimi	Operatori Fitues	Vlera e kontratës
Furnizimi dhe montimi i kondicionerëve në zyrat e Ndërmarrjes	Piramida HVAC SH.P.K.	950.00 €
Furnizimi me derivate	Petrol Company SH.P.K.	3,557.00 €
Furnizimi dhe montimi i emërtimit të Ndërmarrjes në hyrje të objektit format 3D	Adhurim Haraqia B.I.	985.00 €
Furnizimi me material të shtypur	N.B.SH.T."Blini BK" SH.P.K.	955.00 €
Auditimi i jashtëm për vitin fiskal 2022,2023 dhe 2024	"Albaudit"SH.P.K.	4,800.00 € Në realizim – 3 vite
Furnizimi me paisje të teknologjike informative	EGS SH.P.K.	720.00 €
Furnizimi me material zyrtar	N.T.SH."Nobeli"	847.50 €

Njësia Operative / Transporti

Njësia operative gjatë vitit 2023 ka treguar ngritje të kapaciteteve në organizimin dhe ofrimin e shërbimeve të cilat ofrohen nga Ndërmarrja, ku vërehet një rritje e kënaqshme krahasuar me vitet paraprake në inkasimin e të hyrave nga peronizimi.

Në vitin 2023 nga Stacioni i Autobusëve në Gjakovë janë realizuar gjithsejt 42947 linja (duke përfshirë dhe pagesat e parkingjeve të autobusëve), ku krahasur me vitin 2022 parqitet një rritje prej 1,639 linja më tepër të realizuara.

Gjatë vitit 2023 janë realizuar: 26,493 linja në relacionet ndërrurbane, 12,689 në relacionet urban-periferike, 2,995 linja në relacionet ndërkombëtare (bashkëgjatur tabela Nr.1) dhe 770 parkingje të autobusëve.

Gjatë gjithë kësaj kohe janë dorëzuar raporte të rregullta mujore të linjave të realizuara dhe atyre të pambajtura në Ministrinë e Infrastrukturës.

Për kordinimin dhe mbarëvajtjen e sukseshme të operimit nga peronizimi gjatë vitit 2023 janë mbajtur një sërë takimesh me Inspektoratin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Njësinë e trafikut të policisë së Kosovës për ndërmarrjen e hapave dhe masave për shkelësit dhe mospërfillësit e legjislacionit të transportit rrugor, ku bashkëpunimi me këto organe ka sjellur dhe efektshmërinë e saj pasi vërehet dukshëm shtimi i numrit të nisjeve nga Stacioni i Autobusëve, dhe rënia e nisjeve të pambajtura.

Në bazë të kapaciteteve të Ndërmarrjes gjatë vitit 2023 rëndësi i është kushtuar realizimit të intervenimeve dhe ndërhyrjeve të nevojshme në hapësirat e poligonit të peronëve dhe parkingut në mënyrë që operatorëve t'u krijohen kushte sa më cilësore të cilat ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve të cilat ofrohen nga Ndërmarrja. Këto intervenime dhe ndërhyrje në masën më të madhë janë realizuar nga stafi i brendshëm i Ndërmarrjes, duke arritur kështu dhe kursimin e madh të buxhetit të Ndërmarrjes.

Klientët

S.A. SHA ka klientë të cilët sipas veprimtarisë ndahen në:

1.Transportues (shih tabelën 1) – SA SHA është operatori i vetëm në Komunën e Gjakovës i cili ofron shërbime të peronizimit për transportin rrugor, dhe operon me këta operatorë transportues:

Nr	NDËR - URBANE	URBANO- PERIFERIKE	NDERKOMBËTARE
1	CALI	EMRA	BICI –COM
2	METI-TOURS	NORWAY	LOSHI- REISEN
3	DEVA	ÇLIRIMI	BACI
4	DRENI	DEM SADIKU B.I	FESTIMI TOURS
5	SHPAT-TOURS	ARDI TRAVEL	KUJTIMI BUS
6	ARMENDI	ARDI TRANS	SHARR TRAVEL
7	KUSHTRIM N.M		BELI
8	EDONISI		ARMEND TOURS
9	BLEDI		DEVA TOURS
10	NORWAY		TRY TOURS
11	METI-COMERC		BARILEVA TOURS
12	YLLI		MONIKA
13	KASUMI		METI TOURS
14	LUMI-TRANS		EU BUSS
15	DESTANI-TRANS		ZHITIA TURIST
16	ATMAXHA		KUJTIMI PRIJEVOZ
17	ZHURI-REISEN		NEPE NAKAJ
18	HALIMAJ		METI COMERC
19	XENI-TOURS		
20	ALBI		
21	MONIKA		
22	GRAMOZI TRADE		
23	EDI-TOURS		
24	GENTONISI		
25	ERBLINI		
26	SHARR-TRAVELL		

2.Qiramarrës (shih tabelën 2) – SA SHA ofron hapësira për shfrytëzim për operatorët ekonomik, kryesisht të fushës së transporti

Nr	Emertimi
1	Afrim Idrizi
2	Andi Dafota
3	Armend Tours
4	Atmaxha Trans
5	Banana Split
6	Bici Com
7	Cali Agjensi
8	Cali Pastiqeri
9	Dreni
10	Erbliini Tours
11	Ermiri IM
12	Fidani Tours
13	Gentiana Tafarshiku
14	Gerti
15	Gramosi agjensi
16	Gramosi trade
17	Loshi Reisen
18	Kushtrimi Nm
19	Mentor Shehaj
20	Meti Comerc
21	Ministria e trasnportit
22	Norëay Travel
23	Skender Mejzini
24	KK-Bujqesia, Pylltari dhe Zhvillim Rural
25	KK-Kulture, Rini dhe Sport
26	KK- Sherbime publike
27	KK- Drejtoria per pune pergjithshme Administrative
28	KK- Mbrojtje dhe Shpetim

- Vlen të theksohet se dy lokale shfrytëzohen nga shoqata e të verbërve, ku për të njëjtat janë të liruar nga pagesa e qirasë.

Sektori Financiar

Objektiva kryesore në Sektorit Financiar në N.P.L Stacioni e Autobusëve SH.A, është menaxhimi i mirë i burimeve financiare, ku me menaxhimin dhe planifikimin e saktë të shpenzimeve operative të krijojë mundësinë e rritjes së fitimit operativ.

- Sektori financiar vazhdimisht përgatitë raporte mujore financiare ku treguesit kryesor si arkëtimi, faturimi në euro dhe shpenzimet operative, krahasohen me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe me biznes planin e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.
- Për mos realizimin e caceve menaxhmenti do të merr masa që situata të përmirësohet në favor të ngritjes së të hyrave për ndërmarrjen.
- Punët tjera të sektorit financiarë janë përpilimi i raporteve mujore, tre mujore, vjetore, përpilim në zyrën e kontabilitetit financiar si dhe krahasimet e dokumenteve për barazime gjatë regjistrimit.
- Sektori financiar bënë regjistrimin e transaksioneve sipas standardeve të kontabilitetit dhe ligjeve financiare në fuqi, kujdeset që me përpikëri të zbatohen ligjet financiare në përputhje me Administratën Tatimore të Kosovës.
- Librat e tatimeve do të mbahen me një përkushtim të madh ashtu që Ndërmarrja do të koordinoj punët me autoritetin tatimor që në të ardhmen gjatë kontrolleve të mos kemi si obligime tatime shtesë apo gjoba.
- Sektori financiar përpilon dhe prezanton Pasqyrat Financiare vjetore dhe tre mujore.

U.D.Kryeshefi Ekzekutiv

Agron Hoxha



Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve

Arbnore Shehu Bunjaku



Pasqyra e Fitimit ose humbjes dhe te ardhurave tjera gjithëpërfshirës për periudhën Janar – Dhjetor 2023, si dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Nr.	Emërtimi	Realizimi 01.01.2023 - 31.12.2023	Realizimi 01.01.2022 - 31.12.2022	Realizimi %	Pjesëmarrja %
Të Hyrat:					
1	Te Hyrat nga Peronizimi	134,788	127,873	105%	56%
2	Te Hyrat nga Qiratë	69,425	74,604	93%	29%
3	Te Hyrat nga Komp. e Shpnz. Qiramarr	14,634	9,065	161%	6%
4	Te Hyrat nga Parkingu	21,283	9,796	217%	9%
	Gjithsej të Hyrat	240,130	221,338	108%	100%
Shpenzimet:					
1	Shpenzimet e Pagave	169,552	160,024	106%	84%
2	Shpenzimet e Përgjithshme	10,059	15,249	66%	5%
3	Shpenzimet e Furnizimeve	2,222	1,591	140%	1%
4	Shpenzimet e Shërbimeve Publike	13,014	14,379	91%	6%
5	Shpenzimet Tjera (Reprez., Shërb., P)	5,991	6,020	100%	3%
6	Shpenzimet e Zhvlerësimit	2,000	995	201%	1%
	Gjithsej Shpenzime:	202,838	198,258	102%	100%
	Fitimi para tatimit	37,292	23,080	16%	Marzha
	Shpenzimet Tatimit në Fitim	3,729	2,308		
	Fitimi Neto i Periudhës	33,563	20,772	14%	Marzha

Të Hyrat: Stacioni i Autobusëve sipas planit për periudhën Janar - Dhjetor të vitit fiskal 2023, ka realizuar të hyra te përgjithshme në vlerë prej 240,130.00 Euro, kurse krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 janë realizuar te hyra prej 221,338.00 Euro , gjegjësisht kemi realizim te te hyrave prej 108 % krahasuar me vitin 2022, apo tejkalim i vitit paraprak me 18,792.00 Euro.

1) Duke krahasuar grumbullimin (Inkasimin) e të hyrave për këtë periudhë Janar – Dhjetor 2023, konstatojmë se pjesëmarrjen më të madhe të të hyrave arrijnë ta realizoj **Të Hyrat nga Peronizimi** që shprehur në përqindje paraqitet prej 56 % nga të Hyrat totale për këtë periudhë raportimi, gjegjësisht paraqitet me 105 % e realizimit krahasuar me te hyrat e peronizimit te vitit 2022.

2) Të hyra tjera me pjesëmarrje më të madhe janë **Të hyrat nga Qiratë** me 29 % pjesëmarrje e tërësisë se te hyrave dhe me realizim prej 93 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

3) **Të hyrat nga Kompensimet e Shpenzimeve të Qiramarrësve** paraqitet me realizim të krahasimit prej 161%, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 6 % e të hyrave te përgjithshme.

4) **Të hyra nga Parkingu i Veturave**, si e hyrë e re është filluar me menaxhimin e saj nga muaji korrik i vitit 2022 dhe gjatë periudhës raportuese, paraqiten në vlerën prej 21,283.00 Euro dhe pjesëmarrje prej 9 % e të hyrave te përgjithshme.

Shpenzimet: Shpenzimet e gjithmbarshme të ndërmarrjes për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 paraqiten në vlerën prej 202,838.00 Euro, kurse periudha e njëjtë e vitit 2022 në vlerë prej 198,258.00 Euro dhe paraqesin realizimin krahasuar me vitin 2022, prej 102%.

1) **Shpenzimet e Pagave** të punëtorëve për periudhën raportuese paraqiten në vlerën prej 169,552.00 Euro ndërsa shpenzimet e pagave në vitin 2022 në vlerë prej 160,024.00 Euro, ndërsa përbëjnë 84 % e shpenzimeve të gjithmbarshme kurse paraqesin realizim prej 106%.

2) **Në Shpenzimet e Përgjithshme** ku bëjnë pjesë: Shpenzimet e mirëmbajtjes së stacionit, shpenzimet për reklama, provizione bankare, shpenzimet e derivateve dhe udhëtimeve zyrtare, përfshinë pjesëmarrje prej 5 % në shpenzimet të përgjithshme kurse realizimi i shpenzimeve krahasuar me vitin 2022 prej 66 %.

3) **Në Shpenzimet e Furnizimeve** ku bëjnë pjesë: shpenzimet e materialit zyrtar, shpenzimet për blloka dhe bileta etj., zënë pjesëmarrje prej 1% e shpenzimeve të përgjithshme kurse realizim krahasuar me vitin 2022 prej 140 %.

4) **Shpenzimet e Shërbimeve Publike** (rryma, uji, mbeturinat) paraqiten me pjesëmarrje prej 6% të shpenzimeve të përgjithshme, kurse krahasuar me vitin paraprak paraqitet me 91 % e realizimit.

5) **Shpenzimet Tjera** (reprezentacioni, posta dhe interneti, shp. gjyqësore dhe shpërblimet me rastin e festave) paraqiten me pjesëmarrje prej 3 % e tërësisë së shpenzimeve kurse krahasuar me vitin 2022, kemi realizim të shpenzimeve prej 100 % të tyre.

6) **Shpenzimet e Zhvlerësimit** (amortizimit) paraqiten në raport me vitin 2022 prej 201 % (Këtu hyjnë: zhvlerësimi për instalimin e kamerave si dhe zhvlerësimi i riparimit të çatisë në vitin 2020 dhe 2021.

Gjithashtu, raporti i Te hyrave dhe Shpenzimeve paraqet **fitimin e periudhës** Janar – Dhjetor të vitit 2023, pas tatimit në fitim 10%, në vlerën prej 33,563 Euro, me Marzhën të Fitimit prej 14%, dhe në vlerë me të madhe se viti 2022 prej 12,791.00 Euro.

RAPORT VJETOR FINANCIAR

Për vitin që përfundon më 31.12.2023

(SNRF për NVM)

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.,
Adresa: „Kolë Lleshi“ P.N. – Gjakovë /Kosovë
Email: nplsagj@gmail.com , tel: +383 (390) 324 268

Gjakovë, Maj 2024

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A., Gjakovë

NUI: 811444900

Deklaratë e Pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare që përfundojnë me 31.12.2023

Deklaroj se pasqyrat financiare për vitin raportues 2023 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha parimet e koniozës së zbatueshme financiare dhe kërkesat e Ligjit 06/L- 032 për Kontabilitet , Raportim Financiar dhe Auditim .

UD. Kryeshef Ekzekutiv:

Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit:



Gjakovë, Maj 2024

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.

Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023

	Shënimi	2023 €	2022 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	23,621	31,117
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	88,792	88,314
Pasuritë e tjera afatshkurtra	6	<u>1,000</u>	<u>656</u>
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		<u>113,413</u>	<u>120,087</u>
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	1,272,054	1,258,351
Gjithsej pasuritë afatgjata		<u>1,272,054</u>	<u>1,258,351</u>
Gjithsej pasuritë		<u>1,385,467</u>	<u>1,378,438</u>
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	896,204	915,204
Detyrimet e tjera afatshkurtra	9	<u>8,472</u>	<u>13,886</u>
Gjithsej detyrimet		<u>904,676</u>	<u>929,090</u>
EKUITETI			
Kapitali aksionar	10	25,000	25,000
Fitimet e mbajtura	10	52,593	19,030
Rezervat e tjera		<u>403,198</u>	<u>405,318</u>
Gjithsej ekuiteti		<u>480,791</u>	<u>449,348</u>
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		<u>1,385,467</u>	<u>1,378,438</u>

Lehtësimet në leximin e Pasqyrave Financiare paraqiten edhe shënimet shpjeguese nga faqja 19 deri në 23 të cilat janë pjesë e këtij Raporti Financiar.

N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2022	<u>25,000</u>	<u>-</u>	<u>405,318</u>	<u>430,318</u>
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	19,030	-	19,030
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	<u>25,000</u>	<u>19,030</u>	<u>405,318</u>	<u>449,348</u>
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	33,563	-	33,563
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave (tërheqje)	-	-	(2,120)	(2,120)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	<u>25,000</u>	<u>52,593</u>	<u>403,198</u>	<u>480,791</u>

Lehtësimet në leximin e Pasqyrave Financiare paraqiten edhe shënimet shpjeguese nga faqja 19 deri në 23 të cilat janë pjesë e këtij Raporti Financiar.

**Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023**

	Shënimi	2023 €	2022 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit	9	33,563	20,772
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	7	2,000	995
Shpenzimet e interesit		-	-
Shpenzimet financiare		-	-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	(478)	(7,566)
(Rritja) / zvogëlimi i pasurive tjera	6	344	656
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	(19,000)	18,336
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	10	(5,414)	(225)
Tatimi në fitim i paguar		(5,236)	-
Interesi i paguar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)		<u>5,779</u>	<u>32,968</u>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për riparimet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	7	(11,155)	(7,413)
		<u>(11,155)</u>	<u>(7,413)</u>
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare			
Tërheqje		(2,120)	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financiare (III)		<u>(2,120)</u>	<u>-</u>
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë (I+II+III)		<u>(7,496)</u>	<u>25,555</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		31,117	5,562
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	4	<u><u>23,621</u></u>	<u><u>31,117</u></u>

Lehtësimet në leximin e Pasqyrave Financiare paraqiten edhe shënimet shpjeguese nga faqja 19 deri në 23 të cilat janë pjesë e këtij Raporti Financiar.

HYRJE

Raporti Financiar i NPL Stacioni i Autobusëve SHA, për vitin e përfunduar me 31.12.2023 përmban pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (fitimit ose humbjes), pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitete, shënimet plotësuese dhe materialet sqaruese të pasqyrave financiare, të cilat janë të punuara sipas parimeve të kontabilitetit si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi.

Të gjitha këto pasqyra së bashku me shënimet shpjeguese që përmbajnë ato, japin pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare, të fitimit ose humbjes së ndërmarrjes për periudhën raportuese.

Krahas Raportit Financiar për vitin 2023, gjendet edhe Raporti i Auditorit të Pavarur për analizimin e këtyre pasqyrave dhe paraqitjen e opinionit final.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë në Euro

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Gjakovë është Shoqëri Aksionare, e konstituar me datë 05.11.2015 me numër të regjistrimit të biznesit: 71228673, numër fiskal: 601568233 si dhe numër të tvsh: 330311853 me adrese në Gjakovë, rruga "Kolë Lleshi", PN.

Veprimtaria (aktivitetet) kryesore e Biznesit janë:

Primar: Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor,

Sekondar: Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit,

Tjetër: Transporti tjetër rrugor i pasagjereve p.k.t., dhe transporti rrugor urban dhe ndër urban i pasagjereve.

Biznesi posedon aktin me te larte juridik të themelimit - Statutin, nga i cili kemi një aksionar Kuvendin Komunal – Gjakovë, me kapital themelues prej 25,000,00 Euro pas konstituimit ne NPL.

Numri mesatar i të punësuarve në ndërmarrje gjatë vitit 2023 ka qenë 42 punëtor. Në numrin e të punësuarve nuk është përfshirë Bordi i Drejtorëve.

DEKLARATA QEVERISJES KORPORATIVE

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/L-087), Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë është Ndërmarrje Publike Lokale e organizuar si Shoqëri Aksionare e cila përmes Bordit të Drejtorëve i përgjigjet Komisionit të Aksionarëve përkatësisht Kuvendit Komunal Gjakovë si aksionar 100% i vetëm i saj.

Sa i përket aspektit të rregullimit të të drejtave pronësore, NPLSAGJ bie në kuadrin ligjor të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Statutit i Ndërmarrjes të cilat janë aktet me të rëndësishme që e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes. Në bazë të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike nenit 3.2 dhe listës 2 të këtij ligji, NPLSAGJ kualifikohet si ndërmarrje publike lokale. Në bazë të këtij paragrafi, Komuna e Gjakovës zotëron 100 për qind të aksioneve të NPLSAGJ.

Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohen nga një Komision Komunal i Aksionareve, i cili përbehet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtare të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionareve ka të drejtë të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Komisioni i Aksionareve përzgjedh Bordin e Drejtoreve i cili përbehet nga pesë (5) drejtorë. Katër (4) drejtorë zgjidhen me konkurs publik sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve. Drejtori tjetër është Kryeshefi Ekzekutiv i NPL-se i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtoreve të NPL-së në përputhje me Ligjin për Ndërmarrje Publike. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve, Komisioni Komunal i Aksionareve duhet të sigurojë që se paku dy (2) drejtorë të zgjedhur të jenë ekspert, ose se paku të kenë njohuri adekuatë, të kontabilitetit, siç kërkohej nga neni 17.4 i Ligjit për Ndërmarrje Publike.

NPLSAGJ udhëhiqet nga Menaxhmenti i cili përbehet nga Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit, Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari Korporativ dhe Zyrtar i Auditimit të Brendshëm, të cilët zgjidhen nga Bordi Drejtoreve, e që njëherë janë edhe zyrtarët më të lartë në ndërmarrje në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë, si tërësi është e organizuar në dy njësi: 1. Njësia Ekzekutive dhe Administrative dhe 2. Njësia Operative.

1.Njësia Ekzekutive dhe Administrative përfshinë: Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, Shërbimi Financiar, Shërbimi Juridik, Auditimi i Brendshëm, Prokurimi, ndërsa

2.Njësia Operative përfshinë: Njësia Udhëheqëse Afaristë dhe Njësia Afariste Shërbyese.

RAPORTI I MENAXHMENTIT

Angazhimet e menxhmentit dhe koordinimi me njësinë operative të Ndërmarrjes për efikasitetin e shërbimeve me operatorët të ndryshëm transportues, të cilët veprojnë në Stacionin e Autobusëve në relacione të ndryshme: si në linjat urbane, urbane periferike, ndër urbane dhe ato ndërkombëtare, mbetet gjithmonë prioritet i ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2023, në N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë, është rritur vigjilenca rreth ofrimit të shërbimeve operuese dhe përmirësimit të kushteve teknike në Stacionin e Autobusëve, që kanë për qëllim, komoditetin më të mirë dhe më të sigurt të operatorëve, udhëtarëve vizitor dhe punëtorëve, gjë që ka reflektuar pozitivisht në ngritjen e kualitetit të shërbimeve dhe ngritjen e të hyrave nga peronizimi krahasuar me vitet paraprake. Poashtu, janë arritur rezultate në përmirësimin e ambientit dhe kushteve të punës si dhe ngritjen e mirëqenies së punëtorëve.

Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë, operon si tërësi e organizuar në dy njësi hierarkike: 1.Njësia Ekzekutivo-administrative dhe 2.Njësia Operative.

Ndër pikat prioritare investuese të menaxhmentit, përfshihet instalimi i një sistemi të digjitalizuar të operimit më të avancuar, të domosdoshëm për zhvillimin efikas të veprimtarisë sipas praktikave të vendeve të Bashkimit Evropian. Me digjitalizimin e procesit të punës, të inkorporuar me sektorin të financave dhe ndërlidhja me arkën me një program, nga një sistem i centralizuar ngjashëm me vendet bashkëkohore, rrit efektivitetin në punë si dhe eliminon mundësitë e keqpërdorimeve.

Me qëllim të rritjes së të hyrave të përgjithshme parashihet mundësia e instalimit të shitjes së biletave në Stacionin e cila është synim kryesor i ndërmarrjes.

Poashtu, rritja e të hyrave parashihet të bëhet edhe me shtimin edhe më tej të bashkëpunimit me Ministrinë e Infrastrukturës, Kuvendin Komunal-Gjakovë, Inspektoratin e Komunikacionit dhe Policinë për mundësinë e parandalimit të nisëve jashtë stacionit nga disa operatorë të cilët gjërë më tani nuk iu përmbahen këtij rregulli;

Pikë tjetër me rendësi paraqitet aktivizimi i hapësirave të pashfrytëzuara, siç mund të jete lokalet e pashfrytëzuara të Stacionit të Autobusëve për rikostruimin dhe ofertimin e tyre me qira; Shfrytëzimi i hapësirës së objektit të stacionit për pano dhe reklama nga kompanitë afariste që veprojnë në Kosovë, paraqet një sfidë tjetër me potencial gjenerues të të hyrave;

Synim tjetër me rendësi parashikohet, bashkëpunimi i ndërsjellët i ndërmarrjes me organizata tjera simotra dhe përcjelljen e trendëve të reja afariste si dhe aplikimin e përvojave në proceset zhvillimore.

Të gjitha këto prioritete, duke u fokusuar edhe në planifikimin zhvillimor si dhe pika të tjera më rëndësi, po punohet fuqishëm në realizimin e tyre gjatë vitit 2024 duke mos lënë anash edhe monitorimin e shpenzimeve operative.

Risku menaxhues i Ndërmarrjes bartet tek Bordi i Drejtorëve duke u fokusuar në minimizimin e efekteve të kundërta mbi përformacën e Ndërmarrjes. Paraja dhe ekuivalentet e parasë nga saldot në llogaritë bankare nuk bart ndonjë risk sepse Ndërmarrja nuk ka depozita në ekuivalente të parasë në institucione financiare. Po ashtu Ndërmarrja, nuk ka hyrë në transaksione domethënëse të riskut të tregut për të mbuluar ekspozimin e saj ndaj lëvizjeve të çmimeve që dalin prej operimeve të saj. Si rezultat i transaksioneve, risku i valutës së huaj nuk ekziston, për shkak se Ndërmarrja kryesisht kryen transaksione vendore në valutën Euro.

N.P.L.”Stacioni i Autobusëve” SH.A.,Gjakovë shpreh mirënjohje të sinqertë ndaj Kuvendit Komunal - Gjakovë, Policinë së Kosovës dhe Ministrisë për mbështetje të vazhdueshme, për ndihmë në raste të veçanta, në shtimin e nisjeve të operatorëve, për mbarëvajtjen e vijave të rregullta dhe rregullsisë e përgjithshme në Stacion e Autobusëve në Gjakovë.

1. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të) të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Ato janë paraqitur në njësi monetare Euro.

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve. Periudha raportuese e entitetit përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore duke përfunduar me 31 dhjetor të çdo viti. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë krahasuese duke paraqitur në këtë mënyrë saldot për vitin e tanishëm dhe të kaluar.

c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, që është edhe valuta funksionale e Ndërmarrjes.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-në për NVM, kërkon që Menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

e) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat e pozitës financiare dhe ajo e të ardhurave, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon që Ndërmarrja do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe ti mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2. Politika të rëndësishme kontabël

a) Njohja e të hyrave

Të hyrat nga shitja e peronizimit njihen në momentin e lëshimit të biletës së peronizimit, përkatësisht faturës kurse të hyrat nga qiratë njihen kur faturat janë dorëzuar. Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri.

b) Kosto e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

c) Tatimi

N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë paguan tatimin në fitimin të realizuar për çdo periudhë financiare kontabël të kalkuluar në përputhshmëri me Ligjet në fuqi të aplikueshme për periudhën e caktuar, si dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimin dhe kontributet në të ardhura personale.

Ndërmarrja i nënshtrohet ligjit NR.06/L -105 për Tatimin në të ardhurat e Korporatave. Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të pagueshëm aktual dhe në tatimin e shtyrë. Tatimi i pagueshëm aktual është bazuar në fitimin e tatueshem të vitit.

Tatimi i shtyrë njihet nga diferencat ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazat e tyre përkatëse tatimore (të njohura si diferencat e përkohshme). Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen. Pasuritë e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të zvogëlojnë fitimin e tatueshëm në të ardhmen dhe çdo humbje tatimore ose kreditimi tatimor të papërdorur. Pasuritë e shtyra tatimore maten me shumën më të lartë, në bazë të fitimit të tatueshëm të tanishëm ose të ardhshëm të vlerësuar.

Vlera kontabël neto e pasurive të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë të raportimit dhe rregullohet për të pasqyruar vlerësimin aktual të fitimeve të tatueshme në të ardhmen, çdo rregullim njihet në fitim ose humbje.

e) Përfitimet e puntorëve

N.P.L. Stacioni i Autobuseve SH.A., Gjakovë në rrjedhat normale të biznesit, bënë pagesat në emër të punëtorëve për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale të cilat janë të kalkuluar në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrave të të ardhurave për periudhën e caktuar kohore dhe paguhen njëherë në muaj.

f) Prona, pajisjet dhe impiantet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (renia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjate jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

- Ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore 5%
- Impiantet, makineritë 10%
- Pajisjet, inventari, kompjuteret 20%

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvlerësimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie. Zhvlerësimi i pasurisë rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

g) Pasuritë e trupëzuara

Pasuritë e trupëzuara përcaktohen si softueri kompjuterik që njihet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë), amortizohen gjatë jetës së tyre të llogaritur prej 5 vitesh duke përdorur metodën lineare. Nëse ka një ose ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e amortizimit, jetës së dobishme ose vlerës së mbetur të një pasurie të paprekshme, amortizimi rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmeritë e reja. Ndërmarrja nuk ka pasuri të pa trupëzuara gjatë vitit raportues.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

a) Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në çdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatësisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nëse ka një tregues për rënie të mundshme, shuma e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup pasurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shuma e vlerësuar e rikuperushme është e ulet, vlera kontabel ulet deri në shumën që vlerësohet se do të merret, ndërsa shuma e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në qoftë se dëmtimi (humbja nga rënia në vlerë) me pas kthehet, vlera kontabël e pasurisë (ose grup pasurish të ngjashme) rritet për vlerësimin e rishikuar të shumës së tij të rikoperushëm (çmimin shitës minus kostot e shitjes, në rastin e stokeve), parë jo në tejkalimin e shumës që do të ishte përcaktuar nëse nuk do të ishte e njohur asnjë humbje nga rënia në vlerë për pasurinë (grup pasurish të ngjashme) në vitet e mëparshme. Një anulim i një humbjeje nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

b) Rreziku i normës së këmbimit

Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbjesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Ndërmarrja nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontratat e të ardhmes të këmbimit gjatë vitit paraprak.

c) Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Të hyrat nga shërbimet janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes. Të arkëtueshme tregtare të shprehura në monedha të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperushme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlere) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

4.Politka të rëndësishme kontabël

Detyrimet ndaj palëve janë përmbush gjatë vitit 2023. Te ardhurat personale janë paguar gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 në vlere prej 169,552 Euro.

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve nr. 152 të datës 26.04.2021, është ndaluar së ekzekutuari pagesa e viteve të kaluara të punës (stazhit), dhe kjo mbetet obligim për t'u shlyer në momentet kur ndërmarrja të këtë mundësi me te mira financiare. Detyrimet ndaj furnitorëve janë paguar në tersi gjatë vitit 2023.

d) Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutë janë përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

e) Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare. Gjatë vitit 2023 Ndërmarrja nuk ka pasur kredi apo mbitërheqje si të ardhura dhe shpenzime financiare, jashtë të ardhurave dhe shpenzimeve operative.

f) Provizionet për detyrimet e garancisë

Ndërmarrja N.P.L “Stacioni i Autobusëve” SH.A., nuk ka provizione për detyrimet e garancisë për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023.

g) Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara. Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën raportuese

Adoptimi i SNRF16 “Qiratë”.

Në hartimin e pasqyrave financiare merren parasysh të gjitha Rregullatorët dhe Standardet që janë në fuqi në lidhje me Qiratë.

Në vitin 2023, Ndërmarrja ka pasur 28 lokale të lëshuara me qira , 1 parking dhe 2 hapësira në garazhë për parkim të autobusëve apo kombi-busëve, andaj janë aplikuar të gjitha elemente të SNRF16.

4. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Arka	9,153	3,954
Banka	14,468	27,163
Gjithsej:	23,621	31,117

Paraqitja e parasë ne fund te vitit 2023 sipas gjendjes se saldosh ne arkë dhe në bankë.

5. Llogaritë e arkëtueshme tregtare

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Të arkëtueshmet tregtare	88,792	88,314
Provizion i të arkëtueshmeve	-	-
Gjithsej:	88,792	88,314

Në mungesë të dokumenteve kronologjike që nga koha e pasluftes, menaxhmenti për disa vite me radhe ka punuar në evidentimin e borxheve të klienteve sipas vjetërsisë, dhe me Vendim të Bordit të Drejtoreve pjesa e borxhit të klientëve të periudhës para vitit 1999 janë provizionuar, kurse për vitet pasuese janë krijuar marrëveshje për riprogramim të borxhit sipas Ligjit për Faljen e Borxheve me klientët të cilat kanë mundur bashkëpunim. Borxhet tjera të mbetura janë ndare në grupe sipas vjetërsisë deri në 3 vite vjetërsi (të inkasushme), deri në 5 vite vjetërsi (pak të inkasushme) dhe borxhet të cilat gjenden në procedura gjyqësore.

Andaj kemi arritur të bejmë riprogramim të borxhit prej 1005 euro, borxh i cili ka filluar të mbledhet në vitin 2022 një pjesë dhe pjesa tjetër në vitin 2023.

Borxhi i mbetur prej 11,240 Euro edhe pse është borxh me i ri se 5 vite konsiderojmë se është mjaftë sfiduese që të arkëtohen, meqenëse edhe gjykata i parashkruan si lende pas 3 viteve.

Lidhur me këto siç u tha me larte, llogarite e arkëtushme mund te mos kenë vlerën e saktë të kërkesave ndaj klienteve dhe vlera është shumë e mbivlerësuar për te krijuar besueshmëri te pasqyrave financiar deri ne nje provizionim tjetër me Vendim te Bordit te Drejtoreve.

6. Pasuritë tjera afatshkurtra

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Pasuritë tjera afatshkurtra	1,000.00	656.00
Gjithsej:	1,000.00	656.00

Pasuritë tjera afatshkurtra paraqiten saldo parapagimet ndaj tatimit në fitim në fund të vitit 2023.

7. Prona, Impiantet dhe pajisjet

	Toka	Ndërtesa	Inventari	Gjithsej:
Gjendja me 01.2023	924, 987	325,775	7,589	1,258,351
Riparimi i çatisë		3,554	12,148	15,702
Shpenzimet e Zhvlerësimit		(476)	(1,523)	(1,999)
Gjithsej gjendja me 31.12.2023	924,987	328,853	18,214	1,272,054

Gjatë vitit 2021, me procedura të prokurimit publik janë kryer punime në riparimin e hidroizolimit të kulmit të rrafshët lindor në katin e sipërm në N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë në vlerë prej 2,473.73 Euro një pjese dhe 1080.27 Euro pjese tjetër, duke u kapitalizuar per 20 vite si vlerë dhe duke rritur vlerën ndërtesës.

Shpenzimet e zhvlerësimit përfshijnë zhvlerësimet në furnizim dhe montimin e kamerave, zhvlerësimin në riparimin e hidroizolimit të çatisë ne vitin 2020 dhe zhvlerësimin në riparimin e hidroizolimit te çatisë në vitin 2021.

Gjate vitit 2023 procedurat e prokurimit per investime kapitale kane qene ne vlere minimale nen 1,000 Euro, vlere e cila nuk kapitalizohet por hyn direkt ne shpenzimet e

vitit.

8. Llogaritë e pagueshme tregtare

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Të pagushmet tregtare	896,204	915,204
Gjithsej:	896,204	915,204

Që nga data 30.05.2012 me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike 03/L-087 të publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr.13, është vendosur që Stacionet e Autobusëve të jenë në pronësi të Komunave, kështu që në bazë të këtij Ligji, Stacioni i Autobusëve në Gjakovë ka kaluar në pronësi të Komunës së Gjakovës 100%.

Me datë 05.11.2015, Stacioni i Autobusëve u regjistrua pranë ARBK si Shoqëri Aksionare, ku aksionar i 100% të aksioneve të saj është Komuna e Gjakovës. me numër të regjistrimit të biznesit: 71228673 numer unik: 811444900, numër fiskal: 601568233 si dhe numër të Tvsh: 330311853 me adrese në Gjakovë, rruga "Kolë Lleshi", PN.

Stacioni i Autobusëve si trashëgimtare e Kosova Trans ka trashëguar dhe borxhin e tatimeve prej ndaj ATK-se i cili i pa trajtuar ndër vite ka arritur shumën prej 727,330 Euro (periudha 2000-2015v.)

Detyrim tjetër i Stacionit të Autobusëve është edhe ndaj furnitorit "Ngrohtorja e Qytetit" në vlerë prej 10,975 Euro i cili është në procedure gjyqësore, si dhe detyrimi Tatimit në Pronë në vlerë prej 157,899 Euro.

Stacioni i Autobusëve ka mbajtur disa takime me përfaqësues të ATK-së dhe me Aksionarin me të cilët është biseduar dhe është trajtuar mënyra dhe mundësia e shlyerjes së obligimeve të vjetra ndaj ATK-së.

Kurse gjatë vitit paraprak 2023 është bërë pagesa prej 19,000 Euro prej Stacionit të Autobusëve duke zvogëluar pjesën e borxhit të ATK-se për këtë vlerë.

9. Detyrimet Tjera Afatshkurtra

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Tatimi në pagë dhe kontribute 12/2023	1,875	1,495
TVSh e pagueshme 12/2023	3,029	3,001
Detyrimet ne paga dhe stazh	3,568	9,390
Gjithsej:	8,472	13,886

Tatimi ne paga dhe kontribute i muajit 12.2023 paraqitet si detyrim i cili paguhet ne janar te vitit 2024. Tvsh e muajit 12.2023 paraqitet detyrim i pagueshëm ne janar te vitit 2024. Detyrimet ne paga dhe stazh te punëtorëve përfshijnë detyrimet ndaj punëtorëve, dhe ish punëtorëve te cilat paguhen gradualisht me Vendim te Bordit te Drejtorëve gjithnjë sipas gjendjes se përgjithshme financiare.

10. Ekuiteti

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Kapitali fillestar NPL	25,000	25,000
Rezervat tjera Kosovatrans	403,198	403,198
Fitimet e mbajtura	19,030	378
Fitimi i vitit	33,563	20,772
Gjithsej:	480,791	449,348

Fitimi mbajtur dhe fitimi i vitit 2022 ne vlere prej 21,150 Euro (20,772+378), bartja ne vitin 2023 paraqitet ne vlerën prej 19,030 Euro me tërheqjen e vlerës prej 2,120 Euro apo ndarja e rezervave per nevojat investive te ndërmarrjes.

Fitimi i vitit 2023 është në vlerën prej 33,563 Euro, që në relacion me fitimin e vitit paraprak 20,772 Euro, kemi një ndryshim pozitiv të vlerës prej 12,791 Euro.

11. Të hyrat nga Shërbimet

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Të hyrat nga peronizimi	134,788	127,873
Të hyrat nga qiratë	69,425	74,604
Të hyrat nga kompenzimet e qiramarr.	14,634	9,065
Të hyrat tjera	21,283	9,794
Gjithsej te Hyra:	240,130	221,336

Të hyrat nga peronizimi janë rritur gjatë vitit 2023 në vlerë prej 6,915 Euro. Të hyrat nga qiratë në vitin 2023 janë zvogëluar në vlere prej 5,179 Euro pas ndërrimit të Qiramarrësve të lokaleve. Të hyrat nga kompenzimet e qiramarrësve (rryma, uji dhe mbeturinat) në vitin 2023 janë rritur prej 5,569 Euro krahasuar me vitin 2022. Të hyra nga Subvencioni gjatë vitit 2023 nuk ka pasur. Të hyrat tjera përfshijnë të hyrat nga parkingu gjatë vitit 2023 me rritje prej vitit 2022 në vlere prej 11,489 Euro.

12. Shpenzimet Operative

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Mallra dhe shërbime	18,272	21,973
Shërbimet Publike Komunalite	13,014	15,264
Gjithsej:	31,286	37,237

Shpenzimet për mallra dhe shërbime gjatë vitit 2023 kanë qenë më të ulta për 3,701 Euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Shpenzimet e shërbimeve publike (rryma, uji dhe mbeturinat) në vitin 2023 janë më të ulta për 2,250 Euro krahasuar me vitin 2022.

13. Shpenzimet e personelit

	Me 31 dhjetor 2023	Me 31 dhjetor 2022
Pagat Bruto	169,552	160,024
Gjithsej:	169,552	160,024

Paga Bruto gjatë vitit 2023 janë paguar prej 169,552 Euro, kurse gjatë vitit 2022 janë paguar në vlerë prej 160,024 Euro dhe janë më të larta gjatë viti 2023 në vlerë prej 9,528 Euro si rezultat i shtimit të punëtorëve esencial në shërbimin operativ.